



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”

PROCESVERBAL

Tiranë, më 28.06.2018, ora 15:00

Rendi i ditës:

Grupi i deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” pret në takim një grup fëmijësh nga 5 qytete të Shqipërisë, të cilët do të informojnë deputetët për rolin që luan Parlamenti Rinor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.

Marrin pjesë:

Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Elona Hoxha Gjebrea, Klodiana Spahiu, Edlira Bode.

Të ftuar:

Një grup fëmijësh nga disa rrethe të Shqipërisë, që përfaqësojnë grupin e fëmijëve “Zëri 16+”, përfaqësues nga CRCA-ja dhe përfaqësues nga *Save the Children*

HAPET MBLEDHJA

Vasilika Hysi – Përshëndetje! Mire se keni ardhur!

Ju kërkoj ndjesë për vonesën! Ne kemi kënaqësinë që, si grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, t’ju mirëpresim në këtë sallë të Kuvendit të Shqipërisë. Në fakt, janë më shumë deputetë të grupi “Miqtë e fëmijëve”, por sot është seancë plenare dhe një pjesë e tyre janë në seancë, pasi kanë për të diskutuar. Sot këtu janë të pranishëm vetëm një pjesë e deputetëve dhe e këshilltarëve të Kuvendit, të cilët merren me mbarëvajtjen e punës së grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”.

Dëshiroj t’ia jap fjalën Suelës, e cila ju priti në hyrje të Kuvendit, për të shpjeguar diçka lidhur me Kuvendin dhe me mënyrën se si Parlamenti Rinor mund të adresojë kërkesa, shqetësime ose materiale të ndryshme që lidhen me interesin e fëmijëve.

Suela Topi – Përshëndetje!

Faleminderit, zonja Nënkrjetare!

Unë quhem Suela Topi. Jam specialiste në sektorin për kujdesin ndaj qytetarëve, trajtimin të letrave dhe peticioneve. Është kënaqësi që ndodhem përpara jush.

Dua t’ju them dy fjalë lidhur me Kuvendin. Kuvendi, si organi përfaqësues i pushtetit legjislativ, e ushtron veprimtarinë e tij në dy godina. Aktualisht ndodhemi në Kryesinë e Kuvendit, ku zhvillojnë aktivitetin administrata e Kuvendit dhe tetë komisionet e përhershme parlamentare. Ndërkohë kemi edhe godinën tjetër të Rruga e Elbasanit, ku zhvillohen përkatësisht seancat plenare. Zakonisht seancat plenare zhvillohen ditën e enjte, me përjashtim të rasteve të caktuara, në orën 10:00, pra ky është orari i fillimit të një seance plenare.

Puna e Kuvendit konsiston edhe në 8 komisionet e përhershme, të cilat, në varësi të veprimtarisë ose problematikës, janë të ndara në: Komisioni për Sigurinë Kombëtare, Komisioni për Politikën e Jashtme, Komisioni për Integrimin, Komisioni për Arsimin dhe Mjetet e Informimit Publik etj, pra në varësi të problematikës kemi një komision specifik që bën trajtimin e problematikave.

Një formë për të sjellë në vëmendjen e komisioneve dhe të Kuvendit problemet e qytetarëve janë peticionet. Nuk e di nëse ju keni dëgjuar ndonjëherë për peticion, por peticioni është një levë që u është vënë në dispozicion qytetarëve. Qytetarët në rastet kur mendojnë se një problematikë e

caktuar duhet të sillen në vëmendje të Kuvendit, hartojnë një dokument ku të shkruajnë problemin e tyre. E mira është që peticioni të ketë më shumë se 5 firma. Nuk ka një numër specifik, por 1 ose 2 do të ishin pak. Mjafton që qytetarët të shkruajnë në kokën e letrës qartazi fjalën “peticion” dhe të shpjegojnë problemin e tyre dhe bashkë me problemin të dërgojnë bashkëlidhur firmat. Në momentin kur ky peticion vjen në Kuvend, ai kalohet, në varësi të problematikës, pranë komisionit përkatës, i cili e shqyrton problematikën që i ka shkuar. Në raste specifike apo kur lind nevoja për sqarime të mëtejshme grupi i qytetarëve, që ka sjellë në vëmendje një problem të caktuar, mund të thërritet në dëgjese për sqarime të mëtejshme dhe për një zhvillim të mëtejshëm të problematikës.

Në bazë të Kushtetutës, iniciativën ligjvënëse, pra të drejtën për të propozuar ligje, e ka Këshilli i Ministrave, çdo deputet dhe 20 mijë zgjedhës. Në momentin kur ju keni arritur moshën 18 dhe keni të drejtën për të votuar fare mirë, në qoftë se mendoni se keni një problem që ka nevojë për t’u trajtuar, ta sillni në formën e një rregullimi specifik ligjor, mund të mbledhni 20 mijë firma, të hartoni qartazi problemin që mendoni se ka nevojë për trajtim dhe ta dorëzoni në Kuvend. Në momentin kur dorëzohet në Kuvend, në bazë të problematikës, trajtohet dhe diskutohet nga komisioni specifik. Në momentin kur një projektligj i caktuar është trajtuar dhe është diskutuar në një komision, për të cilin është rënë dakord për t’ia kaluar seancës plenare për miratim, futet në rendin e ditës së seancës plenare të radhës (normalisht Kryetari i Kuvendit është ai që drejton një seancë plenare), hidhet për diskutim dhe pastaj për votim. Votimi është i thjeshtë: në formë elektronike, ku deputetët kanë përpara një sistem elektronik, i cili njih secilin deputet që qëndron i ulur përballë, dhe bëhet votimi pro, kundër ose abstenim; votimi tjetër është ai me karton. Është e njëjta gjë, thjesht përdoret kartoni.

Votimi është me shumicë të thjeshtë ose me shumicë të cilësuar, në varësi të votave që kërkon projektligji.

Disa prej jush kanë marrë pjesë në një seancë plenare, i kanë ndjekur seancat plenare. Prej disa kohësh Kuvendi është i hapur për publikun, si ndjekja e komisioneve, ndjekja e një seancë plenare apo një vizitë në sallën e seancave plenare. Tashmë në faqen zyrtare të Kuvendit www.parlament.al ekziston seksioni për qytetarët “Apliko për vizitë”, e cila është një formë shumë e thjeshtë ku ju mund të aplikoni. Mjafton të vendosni të dhënat tuaja personale, arsyen e ndjekjes së seancës apo arsyen vizitës në sallë dhe kërkesa juaj trajtohet, si dhe do të keni një përgjigje që ju konfirmon (zakonisht të gjitha kërkesat që vijnë pranohen dhe ndiqen) se kërkesa juaj është pranuar dhe më pas ndiqet nga shërbimi ynë për shoqërimin në sallë apo në seancë plenare.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit, Suela!

Dua të shtoj se kjo është procedura e zakonshme që ndjek Kuvendi i Shqipërisë. Ju keni mundësi të dëgjoheni, sikurse edhe sot, nga grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, i cili është krijuar në vitin 2013 dhe përbëhet nga deputetë, burra e gra, të të gjitha forcave politike. Pra, nuk është një grupim i maxhorancës apo vetëm i opozitës. Grupi i deputetëve që janë miqtë tuaj është krijuar për të ndjekur më me vëmendje çështjet që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Ne kemi si detyrë për të orientuar të gjithë punën që bëjnë edhe kolegët e tjerë, që nuk janë pjesë e grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, për të ndërmarrë nisma ligjore që mbrojnë më mirë të drejtat e fëmijëve ose nismat ligjore që mund të ketë sjellë Këshilli i Ministrave, një deputetët i vetëm ose 20 mijë qytetarë më firmë, pra t’i shikojmë nëse ata marrin në konsideratë interesin më të lartë të fëmijëve. Gjithashtu, kemi të drejtë të bëjmë seanca dëgjimore dhe ju keni pasur një seancë dëgjimore shumë të mirë në Kuvendin e Shqipërisë, në seancë plenare, ku një pjesë e mirë e deputetëve që janë të pranishëm këtu e kanë ndjekur, e kanë dëgjuar dhe i kanë mbajtur shënim të gjitha rekomandimet, sugjerimet dhe shqetësimet që u ngritën. Në kemi, njëkohësisht, detyrë të promovojmë të drejtat e fëmijëve dhe të monitorojmë qeverinë dhe institucionet e tjera nëse i zbatojnë sa dhe si duhet të drejtat e fëmijëve.

Ky është një grup i hapur. Aktualisht ne jemi 24 deputetë, burra dhe gra, por cilido deputet që ka dëshirë të jetë pjesë, mund t’i bashkohet këtij grupi të deputetëve. Ne kemi edhe një rregullore të grupit dhe kemi bërë edhe një organizim të brendshëm, i cili synon të adresojë çështje të caktuara. Për shembull, ne kemi krijuar 6 komitete, 2 komitete i drejton deputetja që është këtu me ne, Eglantina Gjermani, e cila është edhe kryetarja e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe për Parandalimin e Dhunës dhe mbulon dy komitete që lidhen me çështjet e fëmijëve. Dy komitete të tjera i mbulon deputeti Petrit Vasili, për shembull, shëndeti dhe mirëqenia e fëmijëve; fëmijët në institucionet publike. Ndërkohë, deputetja Gjermani mbulon dy komitete shumë të rëndësishme, për të cilat shpeshherë qoftë parlamenti i fëmijëve, por edhe ai rinor i ngre, si buxhetimi i shërbimeve për fëmijët dhe mbrojtja e fëmijëve nga dhuna, ku përfshihet edhe bulizmi që ju e keni ngritur si shqetësim. Ndërkohë, dy komitetet e tjera, që lidhen me marrëdhëniet me shoqërinë civile dhe të miturit në konflikt me ligjin drejtohen nga unë. Në krye të këtij grupimi është Kryetari i Kuvendit, zoti Gramoz Ruçi.

Në përbërje kemi, gjithashtu, deputetë të profesioneve të ndryshme, që nga Klodiana dhe Edlira, që kanë qenë pedagoge, mjeke; kemi Antoneta Dhimën, deputete në qarkun e Fierit, e cila ka qenë drejtoreshë spitali dhe në profesion është ekonomiste, por që është shumë e dhënë pas çështjeve të fëmijëve; kemi deputeten Elona Gjebrea, nuk e di sa e njihni, të cilën e kemi pasur koordinatore kombëtare kundër trafikimit dhe zëvendësministre e Punëve të Brendshme, e cila ka mbuluar edhe çështjet që lidhen me trafikimin e vajzave, grave, fëmijëve etj. Klodi është deputete e qarku të Durrësit, kurse Edlira e qarkut të Korçës. Eglantina përsëri vjen nga Durrësi, kurse Elona dhe unë jemi deputete të qarkut të Tiranës.

Nuk e di nëse keni pyetje apo doni të bëni ndonjë parashtrim. Bashkë me mua, përveç Suelës, është edhe Xhilda, e cila është këshilltare ligjore, pra ajo bashkë me Joanën, që qëndron në këmbë, janë dy nga personat që ndjekin ose mbështesin grupin e deputetëve “Miqtë e fëmijëve”. Çdo shqetësim që u adresoni ju, mësuesit tuaj, Klaudio, Altini apo kushdo tjetër, i adresohen Suelës, Xhildës, të cilat na informojnë dhe na vënë në dispozicion të gjithë dokumentacionin ose kërkesat dhe ne më pas mblidhemi e i shqyrtojmë.

Ju keni të drejtë që sa herë kur mendoni se keni një çështje për të adresuar, të kërkonti të dëgjoheni nga i gjithë grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve”, por mund të kërkonti t’i adresoheni zëvendëskryetares, zonjës Eglantina Gjermani që t’i kërkonti ta dëgjoni për buxhetin e fëmijëve, ose të kërkonti të dëgjoheni për çështje të dhunës ndaj fëmijëve. Në qoftë se dëshironi të dëgjoni për fëmijët në kontakt me ligjin, do të adresoni një kërkesë tek unë. Nëse dëshironi të dëgjoni për kujdesin, mirëqenien e fëmijëve që mund të jenë në institucione, si në Shtëpinë e Foshnjës, në shkolla e në qendra të tjera, kërkesa i drejtohet direkt zotit Petrit Vasili. Njëkohësisht, ju keni të drejtë t’i drejtoheni edhe një deputeti të veçantë, deputetit të zonës, një deputeti ose një kryetari komisioni për një çështje të caktuar. Unë fola në mënyrë të përmbledhur që t’u japim mundësi juve të adresoni ato që ju dëshironi, por edhe të bëni pyetje.

Kush e do fjalën?

Ju lutem, prezantohuni!

Klent Çupi – Përshëndetje!

Unë quhem Klent Çupi dhe vij nga Burreli. Dua t’i drejtoj një pyetje grupit të deputetëve “Miqtë e fëmijëve”: cilat mendoni se kanë qenë disa nga arritjet tuaja në të mirë të fëmijëve?

Vasilika Hysi – Sikurse ne e thamë, grupi i deputetëve “Miqtë e fëmijëve” është krijuar në vitin 2013 dhe nga viti 2013 e në vijim janë ndërmarrë një sërë nismash lidhur me mbrojtjen e të

drejtave të fëmijëve, të cilat nuk janë ndërmarrë vetëm nga grupi i deputetëve “Miq të fëmijëve”, sepse nismat shqyrtohen nëpër komisionet e përhershme ose nënkomisionet parlamentare, por grupi i deputetëve është ai që ngre zërin, promovon dhe ndikon edhe të deputetët e tjerë.

Ne kemi miratuar një ligj të ri për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Besoj se ju e dini që ka qenë një ligj i vjetër i vitit 2010, por ka qenë shumë formal. Ligji që është miratuar në vitin 2016 është i kompletuar, është shumë i mirë. Ndërkohë, detyra jonë pas miratimit të këtij ligji është monitorimi i tij. Monitorimi i zbatimit të ligjit po bëhet edhe nga nënkomisioni që drejton deputetja Gjermani, por edhe nga një sërë nënkomisionesh ose komisionesh, siç janë Komisioni për Shëndetësinë dhe Çështjet Sociale, Komisioni i Ligjeve, Komisioni i Sigurisë. Pra, në varësi të çështjeve ose të drejtave të fëmijëve, secili komision mbulon aspektet e tij. Për shembull, Komisioni për Ekonominë dhe Financat, ku është anëtare Antoneta Dhima, është një komision i cili fokusohet në çështjet e buxhetimit të institucioneve që merren me fëmijët, me arsimimin. Për shembull, për tekstet mësimore, për kategoritë e veçanta të fëmijëve që duhet të përfitojnë tekste falas etj.

E dyta, në kuadër të reformës në drejtësi, është miratuar për herë Kodi i Drejtësisë për të Miturit. Ne nuk kemi pasur një kod të veçantë për të miturit. Unë e kuptoj që ju këtu jeni nxënës dhe nxënëse shumë të mira dhe nuk keni pasur kontakt me sistemin e drejtësisë, por, për fatin tonë të keq, një pjesë e fëmijëve, e moshatarëve e shokëve tuaj mund të kenë probleme me sistemin e drejtësisë. Ata trajtoheshin më parë sikur të ishin të rritur. Në bazë të këtij Kodi ata trajtohen me të drejtat e një fëmije, duke përjashtuar burgosjen e tyre, sepse burgosja është masa ekstreme, pra duke parashikuar dënimet alternative. Një rol të veçantë mund ta luajë shumë mirë Parlamenti Rinor, marrja nën patronazh e të rinjve, e shokëve tuaj, të cilët mund të gabojnë në jetën e tyre dhe që nuk duhet të izoloohen, por t'i lihen nën kujdes shkollës, komunitetit, një familjeje alternative, një familjeje kujdestare etj.

Gjithashtu, për fëmijët mund ta në flasin shumë mirë dy deputete të tjera. E para, Klodiana Spahiu, e cila ka një përvojë shumë të gjatë në Komisionin për Çështjet Sociale, ku ka kaluar një sërë ligjesh që lidhen me shërbimet sociale etj.. Besoj se Klodi i di shumë më mirë se unë që jam në Komisionin e Ligjeve.

Faleminderit, Vasilika!

Klodiana Spahiu – Faleminderit të gjithëve që keni ardhur sot këtu!

Është e disata seancë dëgjimore që ne bëjmë me grupin e fëmijëve. Në fakt, ju që jeni sot këtu nuk jeni fëmijë, sepse jeni pak më të rritur. Pak më parë po diskutoja më një prej kolegeve tuaja dhe vërtet që një pjesë nga ju kanë mbaruar gjimnazin ose janë në vit të fundit...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Janë fëmijë, por të rritur. Më ju mund të diskutosh plot çështje që ne i kemi kaluar në parlament. Unë do të fokusohem më shumë te disa prej ligjeve që kemi kaluar në Komisionin për Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Kemi diskutuar dhe debatuar gjatë kur kemi kaluar ligjin e ri për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve. Janë zhvilluar disa seanca dëgjimore, madje jo vetëm në komisionin tonë që kemi qenë komision përgjegjës, por edhe në komisione të tjera për dhënie mendimi. Shpresoj që miratimi i këtij ligji, ndoshta ju nuk e kuptoni nen për nen, por ashtu siç tha edhe zysh Vasilika i themi ne, se është pedagoge, do të shërbejë jo vetëm për përmirësimin e cilësisë së jetës suaj, por edhe për përmirësimin në çdo fushë, në çdo hallkë dhe për çdo të drejtë që kanë fëmijët, duke filluar që nga të drejtat themelore për një shëndet sa më të mirë, për një mësim sa më të mirë, të edukohen sa më mirë. Unë besoj se këto biseda që ne bëjmë në parlament të zhvillohen kudo. Shpresoj që grupimi juaj, pra Parlamenti Rinor, të ketë degë edhe nëpër qytete të tjera. Do të jetë mirë që këto biseda të zhvillohen edhe me kolegët tuaj, me shokët dhe shoqet tuaja në qytete të tjera, që të arrijmë të kuptojmë që ligjet që ne miratojmë të bëhen të kuptueshme edhe për ju, në mënyrë që në të ardhmen, ashtu siç tha edhe Vasilika, të keni mundësi të bëni propozimet tuaja konkrete në lidhje me ndryshimet që mund të propozoni në ligj. Pa dyshim që ju vetë nuk mund të propozoni, por me grupin rinor që ju keni, me grupin rinor parlamentar, të cilin ju tashmë e keni konfirmuar dhe shpresoj shumë ta zgjeroni nga dita në ditë, të vijnë nisma ose ndryshime ligjore që do të na shërbejnë të gjithëve, sepse kam parë, kur kemi bërë seancat dëgjimore me fëmijët, që janë raste të përsëritura. Të paktën, këto vitet e fundit ne kemi bërë disa seanca dëgjimore, që janë drejtuar nga fëmijët dhe të them të vërtetën kanë qenë shumë herë më të mira sesa ato që drejtojmë ne, sepse çdo mendim juaji është i sinqertë, ashtu siç e mendoni ju. Më e mira e kësaj është se ne të rriturit nganjëherë nuk i themi gjërat aq troç sa ju, sidomos kur jemi në institucione të tilla, që duhet të mendohesh para se të thuash diçka që është e drejtë ose jo, e vlefshme ose jo. Unë shpresoj që zëri juaj, jo vetëm i atyre njerëzve të fuqishëm që ju drejtojnë dhe në një farë mënyre janë bërë shkaktarë që ju keni ardhur sot këtu, të jetë i fuqishëm dhe i drejtpërdrejtë te brezat që ju përfaqësoni. Shpresoj që në çdo shkollë, sidomos në shkollat e mesme,

të ketë një përfaqësi të caktuar dhe kjo të mos jetë eksperiencë në disa qytete, por në të gjithë Shqipërinë.

Nën drejtimin e zonjës Hysi, të Kryetarit të Kuvendit dhe të kryesisë që ka grupi i fëmijëve unë besoj se takimet do të jenë më intensive dhe do të bëjmë seanca në vazhdimësi për një problematikë të caktuar. Për shembull, nëse do të merremi me shëndetin dhe mirëritjen, pavarësisht se si nënkryetar është caktuar zoti Vasili, ne mund të bëhemi një grup mjekësh ose të bashkohemi të gjithë deputetët mjekë të parlamentit, të bëhemi pjesë e këtij grupi dhe të mendojmë se çfarë mund të bëjmë më mirë për shëndetin e të rinjve dhe të fëmijëve. Ka plot çështje që duhen diskutuar, duke filluar që nga edukimi shëndetësor, që është shumë i rëndësishëm, të përmendet edhe më shumë nëpër shkolla, sidomos në shkollat e mesme. Kur flas për edukimin shëndetësor, mendoj se ka shumë nënproblematika që duhet të fokusohemi, duke filluar që, nga mënyra e të ushqyerit dhe duke vazhduar edhe me problematikat aktuale, siç mund të jetë lufta e vazhdueshme kundër të gjitha drogave, alkoolit dhe duhanit, që, në qoftë se ne bëhemi të gjithë bashkë, mund t'i eliminojmë sa më shumë këto problematika dhe më të shëndetshëm do të rriteni edhe ju.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, doktoresha!

Kush e do fjalën?

Erka Tana – Përshëndetje!

Unë jam Erka Tana, jam anëtare e grupit 0-16+ Elbasan, i cili mbështetet nga organizata “Save the Children”.

Organizata “Save the Children” në bashkëpunim me CRCA-në ka hartuar një raport për të drejtat e fëmijëve, që unë dua ta prezantoj.

Ky raport ka përfshirë në realizimin e tij 300 fëmijë, që i përkasin grupeve 0-16+ të katër qyteteve: Burrelit, Peshkopisë, Durrësit, Elbasanit, si dhe të Parlamentit Rinor këtu në Tiranë.

Problematikat janë përqendruar në tri fusha, të evidentuara sipas fëmijëve dhe konkretisht janë problematika që ato i ndeshin në shkollë, në familje apo në komunitet.

Shkurtimisht po përmend pjesën e shqetësimeve në familje, duke filluar me papunësinë e prindërve dhe varfërinë, e cila shpeshherë bëhet shkak pse fëmijët nuk e ndjekin arsimin dhe lënë shkollën; martesat e hershme të vajzave; mungesa e nevojave bazë, siç janë ushqimet apo veshmbathja; arsimimi i ulët i prindërve, që bëhet shkak për mosndjekjen e shkollës; heqja e ndihmës ekonomike; konflikti mes brezave, ku kemi evidentuar që ka një mungesë komunikimi, e

cila bëhet arsyeja dhe shkaku i konflikteve në familje; marrëdhënia jo e mirë mes prindërve ndikon negativisht te fëmijët; presioni i vazhdueshëm nga ana e prindërve te fëmijët, për faktin se këta të fundit duhet të jenë më të mirët në shkollë dhe komunitet. Pra, nxënësit përqendrohen te rezultatet e larta, pa u përqendruar te synimi kryesor i arsimimit, që është informimi; shfrytëzimi i fëmijëve për punë, si rrjedhojë e gjendjes së vështirë ekonomike; diskriminimi dhe pabarazia gjinore brenda familjes, ku favorizohen më shumë djemtë, anashkalohen vajzat e gratë dhe zëri i tyre në familje mund të mos dëgjohet. Prindërit shpeshherë nuk marrin parasyh opinionin e fëmijëve në familje dhe i diskriminojnë për shkak të moshës së tyre; imponimi i familjes në zgjedhjet e fëmijëve dhe të rinjve, ku shpeshherë prindërit imponojnë fëmijët për atë që do të bëjnë dhe degën që duan të vazhdojnë universitetin; pamundësia për t'u arsimuar për shkak të kushteve të vështira në familje; dhuna fizike dhe psikologjike në familje, ku fëmijët bëhen pre e abuzimit seksual në familje. Këto problematika i lidhim edhe me mosnjohjen e strukturave nga ana e fëmijëve se ku ata mund ta adresojnë problemin.

Një problem tjetër që ne kemi evidentuar te problemet e fëmijëve në shkollë është mosprania e psikologut, që nuk është 5 ditët e javës, ku realisht ka nevojë.

Problematikat që ne kemi evidentuar në komunitet janë pasiguria e fëmijëve dhe të rinjve, se Shqipëria do t'u ofrojë një jetë më të mirë, të sigurt në arsimimin dhe më pas në punësimin e tyre. Ajo që është shqetësuese është se pjesa më e madhe e të rinjve, e evidentuar edhe nga raportet e mëparshme, e shohin të ardhmen e tyre jashtë Shqipërisë. Realisht Shqipëria duhet ta nxisë këtë brez dhe këtë fuqi, por që ta rrisë, duhet ta ushqejë që ata të qëndrojnë në Shqipëri dhe të punojnë për këtë vend. Depresioni te fëmijët është si rezultat i mungesës së perspektivës. Pra, ata nuk e shohin të ardhmen e tyre si sipërmarrës të suksesshëm në punën që do të bëjnë, madje një pjesë e tyre e njohin realitetin dhe e dinë që papunësia është në nivele të larta dhe si rrjedhojë janë në këtë gjendje depresioni; dhuna në komunitet; mungesa e filtrave në internet, që fëmijët të mos kenë akses në disa faqe jo të përshtatshme, e cila lidhet me dhunën kibernetike; mosrespektimi i privatësisë në jetën e tyre, si dhe abuzimi. Pra, jo vetëm bulizmi në shkolla, por edhe bulizmi online është një problematikë e evidentuar nga të rinjtë e 5 qyteteve.

Fëmijët dhe të rinjtë kanë nevojë për punonjës të kualifikuar, që punojnë pranë njësive për mbrojtjen e fëmijëve. Është shumë e nevojshme që këta punonjës të jenë afër fëmijëve, të zhvillojnë takime me to, pse jo edhe takime periodike, në mënyrë që fëmijët të njohin këto struktura dhe të kenë mundësi t'u adresohen atyre në mënyrë të drejtpërdrejtë ose nëpërmjet krijimit të

website-ve për problematikat e ndryshme që ata mund të kenë. Mungesa e hapësirave multifunkionale, ku fëmijët dhe të rinjtë mund të luajnë, argëtohen dhe zhvillojnë hobet dhe pasionet e tyre, qofshin këta edhe qendrat kulturore të të rinjve. Shpenzimi i tepërt i kohës në interenet mbete problem i të rinjve sot, për të vazhduar me pasigurinë fizike për fëmijët e të rinjtë, sidomos për vajzat, të cilat shpeshherë bëhen pre e ngacmimeve të ndryshme nga bashkëmoshatarët dhe nga më të rriturit. Këtu duhet të forcohen sa më shumë strukturat, në mënyrë që t'u gjenden pranë atyre në rast shkeljesh të të drejtave të tyre; diskriminimi ndaj fëmijëve të komunitetit rom, egjiptian, grupeve të ndryshme të marginalizuara apo ndasitë mes fshatit dhe qytetit. Ne kemi struktura për të rinjtë, por këto duhet të jenë gjithëpërfshirëse, si për të rinjtë e qyteteve, ashtu edhe të fshatrave.

Në komunitet ka shumë bulizëm, fëmijët thirren me nofka, ka paragjykime, sharje, të cilat janë pjesë e realitetit të përditshëm. Të gjitha problematikat që ne kemi parashtruar janë pjesë e realitetit tonë të përditshëm.

Pabarazia gjinore. Vajzat në shkolla nuk lejohen të luajnë futboll, ndërkohë në shtëpi djemtë kanë më shumë prioritet. Pra, mbetet ende problem në komunitet dallimi mes vajzave dhe djemve.

Mungesa e infrastrukturës së nevojshme në qytete bëhet shkak për ngacmim ndaj vajzave. Kjo lidhet me infrastrukturën rrugore, siç janë semaforët, vijat e bardha. Individët me aftësi ndryshe duhet të jenë në fokus, ku shkollat duhet të jenë të pajisura me rampe për të mundësuar lëvizjen e tyre. Problem tjetër është mungesa e gjelbërimit.

Pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje mbetet ende problematikë. Shpeshherë fëmijët ndiejnë se problematikat e tyre nuk dëgjohen dhe sugjerimet që ata kanë për përmirësimin e problematikave nuk marrin vëmendjen e duhur. Pra, ministrinë dhe bashkitë nuk akordojnë fonde për fëmijët dhe rrjedhimisht nuk ka investime për fëmijët. Ndërkohë, nga eksperiencia jonë, procese të rëndësishme, si buxhetimi me pjesëmarrje që zhvillon bashkia duhet të përfshijë edhe fëmijët. Në shumicën e rasteve fëmijët nuk dinë si ta bëjnë një gjë të tillë, prandaj ata duhet të trajnohen për rritje kapacitetesh për pjesëmarrjen e tyre.

Ngujimi i fëmijëve si pasojë e gjakmarrjes është problem i ngritur edhe më parë në raportet tona në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, sepse kanë nevojë të dëgjohen.

Kujdesi i ulët shëndetësor të fëmijët, mungesa e analizave, si dhe korrupsioni në shëndetësi janë problematika të ngritura në nivel ndërkombëtar.

Korrupsioni në shkollë. Mësuesit i ftojnë fëmijët për kurse private dhe, nëse nuk shkojnë, ka diferencim në notë dhe fëmija është nën presion të vazhdueshëm, sepse në fund rezultati ka rëndësi dhe jo rruga se si merret ky rezultat.

Mjediset e papastra në qytete. Ujërat e zeza në rrugë, mbeturinat, era e keqe dhe cilësia e ulët e ajrit e shoqëruar me mungesën e hapësirave të gjelbërimit apo hapësirat argëtuese për fëmijët mbetet ende problematikë shqetësuese për ne. Qentë e rrugës, sidomos në Elbasan, janë të pavaksinuar dhe agresivë. Kjo sjell pasiguri në vend. Fëmijët dhe të rinjtë kanë frikë të dalin vetëm pas orës 18:00, kjo edhe nga mungesa e ndriçimit.

Sesioni i fundit i problematikave që ne kemi ngritur janë problematikat në shkollë. Arsimi cilësor falas përqendrohet jo vetëm në pjesën e infrastrukturës, por edhe në problematikat e tjera, siç janë bulizmi, kurset private në shkolla, vendosja e kamerave të sigurisë në shkolla. Ndërkohë i kemi kushtuar rëndësi shërbimit të psikologut. Një psikolog është për 2500 nxënës, gjë që e bën të vështirë që fëmijët të kenë mundësi ta takojnë në rastet kur ata kanë nevojë për të. Pra, ne duam që numri i psikologëve në shkolla të rritet.

Problematikat që ne kemi evidentuar në shkolla janë këto: mungesa e investimeve në pjesën e infrastrukturës, sepse është e rëndësishme që në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies nxënësit ta zhvillojnë këtë proces në kushte cilësore. Këtu flasim për mungesë të sistemit të ngrohjes, mjetet dhe bazat materiale që mungojnë, laboratorët kanë mungesë të bazës materiale, të reagentëve të ndryshëm, mungesa e identifikimit, promovimit si dhe zhvillimit të fëmijëve me një talent të caktuar, vendosja në praktikë e reformës së re Shkolla si Qendër Komunitare, mungesa e mensave në ambientet e shkollave, ku fëmijët mund të ushqehen shëndetshëm dhe të sigurt, praktikë kjo e Perëndimit. Fenomeni bulizëm është në rritje brenda dhe jashtë shkollave, prandaj i duhet kushtuar rëndësi jo vetëm shëndetit fizik, por edhe mendor dhe duhet forcuar komunikimi i fëmijëve me organizma dhe struktura që veprojnë në shkollë, siç janë mësuesit, drejtori, psikologu apo organizma të tjerë.

Mungesa e daljeve të emergjencave në shkollë dhe mungesa e fikseve të zjarrit. Qeveria e nxënësve në shkollë nuk është funksionale. Prandaj, ne sugjerojmë që ky organizëm të forcohet, sepse është një mënyrë e drejtpërdrejtë që zëri i fëmijëve të dëgjohej.

Së fundi, kemi disa rekomandime, që ne duam t'ua adresojmë organizmave qeveritare: ne duam që të rritet buxheti për arsimimin në Shqipëri; më shumë investime për përmirësimin e infrastrukturës dhe cilësisë së mësimdhënies në shkolla; ne duam përmirësimin e infrastrukturës

së shkollave, si dhe pajisjen e të gjitha shkollave me biblioteka, palestra dhe laboratorë; ne duam të hapen zyrat e komisionerit për të drejtat e fëmijëve dhe të avokatit të popullit në çdo qark të Shqipërisë dhe të kenë komunikim të drejtpërdrejtë me ta; të hapen zyrat e këshillimit të karrierës në çdo shkollë. Kjo do të evidentonte gjendjen depressive; të rritet fondi për bursat, si dhe të rriten shërbimet shëndetësore për fëmijët dhe të rinjtë në Shqipëri; shkollat të bëhen të aksesueshme për fëmijët me aftësi ndryshe, të ketë rampe në shkolla dhe qytete; ligjet dhe politika të formulohen dhe të interpretohen sa më thjeshtë për fëmijët dhe të rinjtë në vend; platformat online dhe offline të organizmave të ndryshme qeveritare të jenë miqësore ndaj fëmijëve; të zhvillohen takime periodike mes deputeteve dhe fëmijëve për problematikat që ata ndeshen. Pra, ata të kenë mundësi të drejtpërdrejtë të komunikojnë dhe të adresojnë problematikat e tyre; përshtatja e të gjitha *websiteve* në gjuhën e fëmijëve; të rritet numri i punonjësve të shërbimit psikosocial në shkolla; hartimi i një ligji për përmirsimin e arsimit parauniversitar dhe universitar në bashkëpunim me fëmijët nëpërmjet forumeve të ndryshme, siç është ky i sotmi; të rritet siguria në shkolla, si dhe të vendosen kamera sigurie në ambientet shkollorë; të organizohen fushata ndërgjegjësuese për rëndësinë e arsimit, psikologut, punonjësit social, pasojat e përdorimit të lëndëve narkotike e të tjerë. Ne pa dyshim duam që numri i psikologëve të rritet dhe duam që fëmijët të nxiten dhe ta bëjnë pjesë të mentalitetit të tyre të përditshëm që vizita te psikologu është e shëndetshme dhe nuk ka arsye për bulizëm dhe diskriminim; të hapen qendra rinore multifunksionare me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për zhvillim të veprimtarisë të të rinjve; të rritet numri i bursave për nxënësit e ekselencës ose për të talentuarit; hartimi i një mekanizmi për raportimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna në shkollë dhe jashtë saj dhe të punësohen mësues të kualifikuar dhe miqësorë me fëmijët.

Ky ishte shkurtimisht raporti i Save the Children në bashkëpunim me CRCA-në. Ne shpresojmë që takime të tilla të vazhdojnë të nxiten, sepse, në fund të fundit, u japin mundësi fëmijëve të shprehin problematikat e tyre dhe të gjejnë zgjidhje.

Faleminderit!

Vasilika Hysi –Faleminderit për prezantimin!

Meqenëse një pjesë e mirë e deputetëve kemi qenë në sallën e seancave dhe raportin e kemi, është mirë që një përmbledhje e rekomandimeve t’u adresohet deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë. Ne kemi marrë edhe një botim në seancë, por do të ishte mirë që ta kemi me shkrim,

sepse disa rekomandime lidhen drejtpërdrejt me ju, disa lidhen me komunitetin në tërësi dhe disa duhen bërë sa më shpejt.

Pesa Vraçi – Përshëndetje!

Emri im është Pesa Vraçi dhe dua të flas në emër të organizatës “Parlamenti Rinor i Tiranës”. Kjo organizatë është krijuar për një qëllim të qartë, që ne si të rinj të kemi ndikim në vendimmarrje jo vetëm në rang lokal, por edhe kombëtar. Ky si qëllim është utopik, por është ëndrra jonë që ta arrijmë.

Është e thjeshtë të flasim për problemet, sepse ka kudo. Edhe duke ecur në rrugë mund të gjesh diçka që nuk të pëlqen dhe mund të rregullohet.

Ashtu siç foli edhe kolegja më parë, ne si organizatë kemi si qëllim që të priorizojmë këto problematika. Edhe gjatë trajnimit po flisnim që ne duhet t’i priorizojmë problemet tona, sepse ne nuk mund të jemi të gjithanshëm dhe t’i mbulojmë të gjitha problemet, pasi nuk mund të identifikohemi në mënyrë të qartë tek organet më vonë. Kur dikush të mendojë për Parlamentin Rinor, qëllimet tona duhet të jenë të qarta dhe të fokusuara.

Në emër të të gjithë deputetëve të Parlamentit Rinor duam që të merrnim ndihmën tuaj, në mënyrë që edhe ne të kemi fokusin tonë se ku janë boshllëqet dhe ku mund të punojmë ne më së shumti, sepse kam vënë re që ka mungesë informacionesh, sondazhesh, apo raportesh. Raporte të tilla janë informacione në ajër, prandaj ne duam gjëra më konkrete. Ne duam mbështetjen tuaj, edhe për qartësimin e organizimit tonë si një i tërë.

Faleminderit!

Vasilika Hysi- Shumë faleminderit!

Në faqen Kuvendit, secili prej jush ka të drejtë të njihet me kalendarin e projektligjeve që diskutohen. Kalendarin dhe programin e veprimtarisë së Kuvendit botohet çdo tri javë. Po të futeni te faqja e Kuvendit, në kalendarin e punimeve do të keni listën e të gjitha projektligjeve. Aktualisht, ligji që ka interes për ju, është ligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin “Për parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare”, për të cilin të gjitha deputetet, koleget e mia, që jemi këtu kemi kontribuar. Ditën e hënë fillon diskutimi në parim për këtë ligj në Komisionin e Ligjeve. Ne kemi parashikuar një seancë dëgjimore me institucionet, kryesisht ato që lidhen me çështje të kushtetutshmërisë, të marrëdhënieve me administratën publike, me organet e qeverisjes vendore, meqenëse jemi komisioni përgjegjës. Po të dëshironi ju, mund të vijë një përfaqësi, sepse kaq sa jeni ju është e pamundur, por 2-3 deputetë të rinj, mund të jenë të pranishëm. Projektligjin mund

ta shikoni që sot në faqen e Kuvendit, sepse është i botuar, ndërkohë keni dhe relacionet e komisioneve që kanë qenë komisione për dhënie mendimi, dhe mund të shprehni mendimin tuaj për mbrojtjen më të mirë të fëmijëve nga dhuna në marrëdhëniet familjare. Vetëm dua t'ju bëj me dije që jo vetëm CRCA-ja, por edhe institucionet e tjera, duke përfshirë avokatin e të miturve tek Avokati i Popullit, Ministria e Brendshme, Prokurorinë e Përgjithshme organizatat e shoqërisë civile, UNICEF-i, kanë sjellë shumë mendime dhe sugjerime për të rregulluar më mirë mbrojtjen e të drejtave të fëmijës në rastet e dhunës në familje, për të cilat ne sot, si grup pune, kemi punuar dhe pothuajse pjesën më të madhe do ta marrim në konsideratë. Ju mund të vini dhe të jepni ndonjë mendim tuajin. Pikërisht, për këtë do të bëni procedurën që tha Suela. Jo pa qëllim foli Suela në fillim dhe më tregoi procedurën e përgjithshme. Pra, bëni një kërkesë që duhet të jeni në Komisionin e Ligjeve, sepse ky është i vetmi komision që ka mbetur për ta shqyrtuar, jepni emrat te seksioni “Për qytetarët”.

Suela Topi – Jepni emrat te seksioni “Për qytetarët”, aplikoni për vizitë dhe ndjekje të një komisioni apo ndjekjen e një seance plenare. Plotësohet formulari përkatës, aty gjendet edhe adresa e *email*-it, ku ju mund të dërgoni dhe normalisht do të keni edhe përgjigjen, sepse të gjitha kërkesat pranohen dhe kështu që nuk do të ketë probleme për ndjekjen e komisionit apo të seancës.

Vasilika Hysi – Nëse ju keni ndonjë mendim konkret, bashkë me mësuesit që ju drejtojnë për ndonjë nen, që nuk ju pëlqen mënyra se si e adreson dhunën ndaj fëmijëve, do të ishte mirë që në fillim të dërgohet në adresë të koordinatorit për shoqërinë civile në Kuvendin e Shqipërisë, që më pas e adreson në Kuvend. Në rast se do ta thoni aty për aty dhe ne jemi duke diskutuar ligjin nen për nen, ka një vështirësi, sepse ne nuk mund ta riformulojmë nenin aty për aty. Pra, është mirë t'i kemi më parë, për shembull, t'i sillni nga e hëna, e marta, e mërkura, meqenëse diskutimi në parim do të jetë javës tjetër, por nen për nen do të jetë pas datës 9 dhe në këtë mënyrë mendimi juaj përfshihet. Unë, si relatores, do ta lexoj dhe do të them se ky nen ndryshon sipas propozimit të parlamentit rinor, në qoftë se merret në konsideratë, ose ky propozim i parlamentit rinor nuk merret në konsideratë për këtë arsye, sepse jo gjithçka që ju thatë përfshihet në një ligj konkret, mund të jetë e nevojshme të përfshihet në ligjet e tjera. Jeni të mirëpritur te ky ligj, sepse ky është për momentin.

Urdhëroni!

Vajzë - E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar kolegë,

Në fakt, nuk doja të thosha problemet që hasim çdo ditë, sepse të gjithë i dimë, por dua të ngre një pyetje për të gjitha zonja që kanë mbaruar studimet e larta në fushën e mjekësisë, pasi edhe vetë dëshiroj të bëhem mjekë në të ardhshmen. Unë dua ta shtrij veprimtarinë time përtej spitalit, qendrave shëndetësore, poliklinikave dhe ambulancave. Dua të di: se cila është mënyra më e mirë për ndërthurur arsimin me shëndetësinë?

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Të lutem, edhe një herë pyetjen?

Vajzë - Cila do të ishte mënyra më e mirë për të ndërthurur arsimin me shëndetësinë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Domethënë, si mund të bëjmë një lidhje midis shëndetësisë dhe arsimit? *(Ndërhyrje pa mikrofon)*

Thashë: meqenëse ju keni studiuar për mjekësi dhe unë dua të vazhdoj këtë rrugë që ju keni ndjekur, atëherë do të doja ta shihja veprimtarinë time përtej spitalit, qendrave shëndetësore, poliklinikave dhe ambulancave dhe dua ta bëj veprimtarinë time të ndërthuru me shkollën.

Atëherë, cila do të ishte mënyra më e mirë për të ndërthurur arsimin me shëndetësinë?

Klodiana Spahiu – Në fakt, kur mora fjalën pak më parë, ishte ideja se një mënyrë shumë e mirë është puna me fëmijët, se si mund të rriten të shëndetshëm. Ndoshta, kjo do të jetë dhe ndërthurja. Edukimi shëndetësor apo arsimi me shëndetësinë, pa dyshim që janë shumë të lidhur me njëri-tjetrin, sepse të bëhesh një mjek i mirë, së pari, duhet të kesh qenë një student shumë i mirë në mjekësi. Mendoj se të gjitha ato ligje që janë miratuar në fushën e arsimit, sidomos ligji “Për arsimin e lartë”, dhe mbyllja e një sërë universitetesh private, të cilat nuk nxirrnin nivelin e duhur të studentëve, mendoj se është ndoshta reforma më e mirë dhe më pozitive për ju, brezin e ri, për të dalë studentë shumë të mirë në të ardhmen.

Pa dyshim lidhja e arsimit me shëndetësinë nuk mund të shikohet ndryshe. Studentët tanë që kanë mbaruar mjekësi kudo në botë kanë treguar se ka një nivel shumë të mirë dhe janë pranuar kudo, por për ju do të mjaftonte dhe do të ishte shumë e rëndësishme që të kishit një formim sa më të mirë në shkollën ku jeni, sepse është baza për të ardhmen dhe një themel i mirë i shkollës së mesme është një hap shumë i mirë për ata studentë, që do t’i hyjnë fushës së gjatë të mjekësisë. Pa dyshim, ju bëni orë të edukimit shëndetësor, dhe shpeshherë ju i quani orë të lehta, por që janë shumë të rëndësishme, sepse një edukim i mirë shëndetësor juaj në të gjitha fushat, në fushën e

shëndetit seksual dhe në fushën e shëndetit mendor, pra në të gjitha fushat është shumë i rëndësishëm që ju të kuptoni rolin e madh që ka të qenurit i shëndetshëm në shoqëri. Tani nuk e di se sa mund t'i jem përgjigjur pyetjes suaj.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Urdhëroni, zonja Hoxha!

Edhe Elona ka qenë mjekë, megjithëse është për gjenetikë.

Elona Hoxha – Në fakt, unë kam punuar në spital për 10 vjet, por kam punuar edhe në një organizatë joqeveritare, që merrej me çështjet e shëndetit riprodhues, jam edhe pedagoge. Kështu që do të përpiqem ta ndërthur me disa gjëra. Mendoj se ju të rinjtë që aspironi të ecni përpara në fushën e mjekësisë, mund të punoni më shumë për të advokuar për shërbime për të rinjtë, të cilat janë miqësore. Për shembull, në qoftë se ju shkoni, qoftë edhe te materniteti qendror, dhe kërkoni shërbime miqësore për të rinjtë, do të shikoni se ka vetëm një qendër për gratë, por nuk është se ka shërbime që kanë të bëjnë dhe me kontracepsionin, me shëndetin riprodhues e të tjerë. Gjithsesi ka disa sugjerime. Ka ditë të caktuar të shëndetit që kemi nevojë për mbështetje nga të rinjtë dhe përsëri mund të bëhen aktivitete të përbashkëta, pse jo edhe me aleancën e grave me komisione të ndryshme nënkomisione të ndryshme, që ne kemi, për të sensibilizuar probleme të ndryshme. Për shembull, edhe për ndihmën e shpejtë. Mua, më ka rezultuar me studentët, që shumë studentë nuk dinin, pavarësisht se kishin shkuar në provime, aq me tepër që janë të lidhura dhe kanë të bëjnë me patentën, përsëri bënin disa trajnime sipërfaqësore dhe nuk ishin në gjendje që të dinin apo të tregonin se kishin njohuri të mjaftueshme për situata të ndihmës së shpejtë. Kemi probleme të ndryshme, që kanë të bëjnë, për shembull, me çështje të ndryshimit të strukturës së popullsisë, të migrimit, që është një fenomen jo vetëm shqiptar, por ndodh gjithandej. Përsëri ka mundësi dhe hapësira për të lobuar dhe për të folur më shumë për çështje se si të rinjtë mund të ndihmojnë në fusha të ndryshme. Pra, ka mundësi pa fund që ju të shërbeni më mirë. Nga ana tjetër, një grup të rinjsh mund të fillojë të lexojë një ligj të caktuar, ku ju jeni të interesuar, të merret një ekspertizë e caktuar dhe kur vjen puna të na ndihmoni edhe ne me një lobim për çështje që kanë të bëjnë me të rinjtë, duke u adresuar nga të rinjtë, pasi edhe ne jo gjithmonë e kemi atë informacionin e duhur dhe jo gjithmonë arrijmë në një ligj të caktuar të japim mendimet e duhura për çdo gjë.

Nënkryetarja e Kuvendit tha se ne jemi duke diskutuar për ligjin “Për dhunën në familje”. Faktikisht, është bërë një seancë dëgjimore me grupet e interesit, por, sigurisht, jam e bindur që ka edhe aspektet të tjera, të cilat, po të adresohen nga shumë grupe të interesit, përfshirë këtu edhe të

rinjtë, do të dalë një ligj bashkëkohor dhe do të përmbajë shumë problematika. Gjithsesi, unë jam e hapur për të folur me ju në mënyra të tjera, qoftë edhe nëpërmjet *email*-it, por edhe, pse jo, me takime dhe me seanca të tjera.

Faleminderit, që keni ardhur! Ju inkurajoj dhe ju uroj shumë suksese në sfidat tuaja që keni përpara! Kini parasysh që jeni një brez që keni shumë konkurrentë dhe kjo do të thotë se edhe ju duhet të jeni shumë të përgatitur për atë të ardhmen që ju pret. Patjetër do të jetë një e ardhme shumë e bukur dhe shumë më e mirë se ajo që kemi jetuar ne, brezi i deputetëve, që kemi jetuar edhe në periudhën e komunizmit dhe tani jemi në periudhën e demokracisë. Na është dashur që, me sfida shumë të mëdha të bëjmë përpara në karrierën tonë, duke mos harruar që jemi gra e nëna dhe kemi edhe detyrime të tjera.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit!

Dëshiron dikush tjetër të marrë fjalën, sepse na ka ardhur njoftimi për të votuar në seancë plenare.

Urdhëroni!

Antoneta Dhima - Faleminderit, zonja Hysi!

Në fakt, me një pjesë të fëmijëve jemi takuar edhe në datën 1 qershor, dhe vajza që referoi aty ka qenë pjesë e takimit. Vasilika është përpjekur dhe ka organizuar mjaft takime me të rinjtë dhe për këtë dua ta falënderoj. Ky nuk do të jetë takimi i vetëm. Problematikat dhe problemet që vajza ngriti, me të drejtë, nuk janë probleme që ne nuk i njohim, i njohim shumë mirë, por është shumë e rëndësishme nga drejtuesit që punojnë bashkë me ju edhe nga ju vetë, të adresohen që ato të marrin zgjidhjen e duhur. Ne si kolege mbulojmë zona të caktuara dhe patjetër që takohemi me të rinj dhe të reja, patjetër që marrim probleme dhe shqetësime, të cilat presin zgjidhje nga ana jonë, si parlamentarë, por edhe ju nuk duhet të jeni indiferent atje në shkollën ku jeni, të ngrini zërin për të drejtat tuaja.

Në fakt, zonja Hysi e tha se ne jemi duke diskutuar projektligjin “Për dhunën në familje”. Gjithkush nga ju mund të japë mendime dhe gjykime për përmirësimin e këtij ligji, nuk është se ai do të miratohet dhe nuk mund të ndryshojë. Patjetër që çdo projektligj, i cili miratohet në parlament, mund të ndryshohet në vazhdimësi.

Vajza pyeti për pjesën e arsimit me shëndetësinë: edhe kjo pjesë është shumë e rëndësishme, sepse në qoftë se nuk do të kemi fëmijë të shëndetshëm, patjetër që nuk do të kemi

një shoqëri të shëndetshme. Faktikisht, çdolloj fushe është e lidhur me qenien tonë njerëzore dhe patjetër gjithsecili nga ju duhet të japë kontributin e tij në të gjitha fushat. Ju uroj të gjithëve suksese! Në fakt, pjesa më e madhe juaja janë gjimnazistë, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vajza – Të gjithë jemi gjimnazistë.

Antoneta Dhima - Në qarkun e Fierit parlamenti rinor ka funksionuar dhe funksionon. Ata marrin iniciativa nga më të ndryshmet për zhvillimin e qytetit. Policimi në komunitet ka qenë një projekt, të cilin çdo vit e kanë përfaqësuar shumë mirë të gjithë brezin tuaj. Besoj se edhe parlamenti rinor i Tiranës, ka iniciativa, ka programe, normalisht ka edhe projekte konkrete, me të cilat ju do të punoni jo vetëm në këtë periudhë, por patjetër edhe në vitet në vazhdim.

Unë ju uroj suksese dhe faleminderit që ishim bashkë sot!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Dhima!

Urdhëroni!

Edlira Bode – Faleminderit!

Pa u zgjatur, rastësia e solli që këtu afër të ulet Dorina, qenka një nxënëse e dhe ka fituar një bursë studimi për në një shtet jashtë Shqipërisë, dhe, në fakt, ka vendosur të vazhdojë studimet në Shqipëri, jo jashtë. Qëllimi jonë i përbashkët, pra joni dhe juaji është që Shqipërinë ta bëjmë zgjedhjen e parë të secilit prej jush, dhe këtë mund ta bëjmë vetëm së bashku.

Prandaj, faleminderit, që keni ardhur dhe të jeni gjithmonë të pranishëm, në mënyrë që çdo gjë që bëjmë të sjellë përmirësime të tilla në vendin tonë, që asnjëri nga ju mos të ketë dëshirë të largohet!

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja Bode!

Doktoreshë Edlira ka studiuar në Itali dhe ka ardhur dhe për të punuar si mjeke në Shqipëri, ja modeli, dhe aktualisht kontribuon në Komisionin e Shëndetësisë. Por edhe Eglantina Gjermani ka studiuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe ka kontribuar në Shqipëri, duke krijuar lëvizjen e gruas dhe duke vazhduar të kontribuojë në Kuvend. Po të shikoni, pjesa më e madhe e deputetëve, që ju i shikoni ose jo, i kanë përshkruar sikur janë pa shkollë, por janë njerëz që kanë studiuar jashtë, kanë kontribute dhe kontribuojnë shumë. Këtu ne jemi një pjesë, por ka shumë deputetë, burra dhe gra, të mirëshkolluar që kanë kontribuar dhe sot janë të dobishëm, por ne kemi nevojë

të ndryshojmë gjuhën e komunikimit në seancat plenare, sepse kur jemi në komisione, siç jemi këtu, jemi kaq të mirë, siç na shikoni sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur ka televizor deputetët ndryshojnë, sepse mendojnë se ju, që i shikoni si mbështetës ose prindërit tuaj i pëlqejnë ashtu, agresivë. Kur janë pa kamera, siç jemi sot, megjithëse ka kamera, por nuk ka kamera të televizorit, deputetët falsin shumë normalisht dhe diskutojnë profesionalisht.

Po ia kaloj fjalën Klaudios, sepse mua më ka ardhur njoftimi nga Kryetari i Kuvendit, që duhet të paraqitem në seancë për të votuar.

Vajzë – Raporti që ne prezantuam sot nuk është raporti që prezantuam me 1 qershor, është një raport alternativ, i realizuar nga CRCA-ja në bashkëpunim me zërin 16+ Elbasan. Unë jam nga Elbasani dhe e ndiej këtë pjesën, prandaj më vjen natyrshëm, i cili është një grup i udhëhequr nga fëmijët që mbështetet nga “Save the Children” në bashkëpunim me parlamentin rinor. Është një raport, i cili paraqet problematikat e fëmijëve dhe të rinjve, ku ne sot gjejmë hapësirën për t’i adresuar ato me vizionin për të gjetur zgjidhje për këto problematika.

Vasilika Hysi – Meqenëse është një raport alternativ, ne do ta mirëprisnim, të silltet në mënyrë zyrtare në adresën e Kuvendit të Shqipërisë, që më pas ta shpërndajmë te kolegët deputetë.

Urdhëroni, zoti Pulaha!

Klaudio Pulaha – Faleminderit për këtë seancë! Ishte vërtet kënaqësi, e pashë përsëri këtë sallë plot e përplot me të rinj, pavarësisht se kanë qenë edhe më parë! Realisht, ndërhyrja e koleges ishte me vend. Materiali që sapo vajza prezantoi pak më parë, është një dokument draft, i përgatitur nga CRCA-ja Shqipëri, duke iu referuar 5 konsultimeve në 5 qytete, si: Burreli, Peshkopia Tirana, Elbasani dhe Durrësi. Domethënë, ato problematika do të formulohen

dhe riformulohen dhe më pas do t’i dërgohen komisionit, madje edhe grupit “Miq të fëmijëve”.

Për sa i përket pjesës tjetër, që duhet të zgjedhim Shqipërinë apo jashtë, unë jam partizan, të qëndruarit brenda, sepse kemi mjaft modele pozitive dhe këtu ndodhet edhe një ndër zyshat e mia të nderuara, zyshë Eglantina, dhe kemi marr shembull dhe ja ku jemi sot dhe kontribuojmë në Shqipëri.

Faleminderit!

Vasilika Hysi – Faleminderit, Klaudiu!

Harrova se edhe zyshë Elona ka mbaruar në Angli dhe ja ku kontribuon në Shqipëri dhe me të vërtetë janë modele shumë të mira. Unë dua t'ju falënderoj të gjithëve!

Miq të dashur, në fund të kësaj seance, do të kërkonim që të kishim një raporte alternativ. Po ashtu i kërkoj edhe “Save the Children”, meqenëse një pjesë ka qenë dhe me raportin e parë, të na vijë edhe raporti i parë, që ne t'i ndajnë sipas nënkomisioneve dhe komisioneve, por grupi të deputetëve “Miq të fëmijëve” duhet t'i shkojë i gjithë raporti i plotë. Sikurse tha deputetja e parlamentit rinor të Tiranës të ndahen në bazë të prioriteteve, të vihet një përparësi, kë do të dëshironit ju të kishit si çështje më parësore në sugjerimin tuaj, ndërkohë edhe ne do t'i vlerësojmë përparësitë tona dhe jeni të ftuar javës tjetër të jepni mendime për ligjin “Për shtesa dhe ndryshime në parandalimin e dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Një ekip me 2-3 përfaqësues, do të ishte shumë i mirëpritur dhe me këtë rast ju hapnit menjëherë praktikën e të dëgjuarit jo vetëm të rriturve, të institucioneve, kryesisht do të jenë institucionet kushtetuese dhe institucionet e tjera që do të dëgjohen, sepse një pjesë e shoqërisë civile është dëgjuar në komisionet përkatëse, por shumë mirë le të jetë edhe një grup i parlamentit rinor. Në emrin tuaj, dua të falënderoj stafin Suelën, Xhildën dhe Joanën, por këtu kemi dhe një eksperte të UNICEF-it, profesoreshë Iva Zajmi, që e keni në këmbë! Falënderoj stafin e Kuvendit, vajzën e teknikës, që mundësoi gjithë këtë aktivitet!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA